



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 20434, prot.

Lezhë, më: 30.12 .2024

### RELACION

**PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS TË HEQJES NGA FONDI PYJOR  
KOMBËTAR PËR SIPËRFAQET QË DO TË PREKEN NGA NDËRTIMI I  
OBJEKTIT KOMPLEKS TURISTIK, RESORT ME SUITA 1, 2, 3, 4 DHE 5 KATE  
MBI TOKË DHE 1 KAT MBI TOKË NË PASURITË 1000/35, 1004/2 DHE 1004/4  
ZONA KADASTRALE 2568**

Shoqëria **“PRINCE ADRIATIK RESORT” SHPK** dhe shoqëria **“PRINCE JUNIOR SHPK”** kanë paraqitur kërkesën online me datë 19.11.2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për heqje nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes, ku sipas Vendimit të KKT-së numër 39 datë 26.12.2023 për miratimin e Lejes së Ndërtimit do të ndërtohet objekti; Kompleks Turistik, Resort me suita 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqes **0.99 ha** pyll që do të shërbejë për ndërtimin e Komplexit Turistik, Resort me suita 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet shkresës numër 7520 protokoll datë 02.12.2024 i është drejtuar Bashkisë Lezhë për hartimin e Raportit Tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes që preket nga gjurma e ndërtimit, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III të VKM-së numër 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.


Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë, është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga gjurma e ndërtimit. Sipërfaqet pyjore janë në pronësi të Shoqërive **“PRINCE ADRIATIK RESORT” SHPK DHE “PRINCE JUNIOR SHPK”** sipas dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria dhe të përcjellura nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe bëjnë pjesë në ngastrat pyjore numër 62a dhe 62c të Ekonomisë Pyjore “Mali i Rrencit”.



Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **0.99 ha** pyll në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur Projekt-Vendimit.


Hartoi relacionin

Ing. Artan PALUSHI



DREJTORI

Gjek MAKAJ



KRYETARI  
Pjerin NDREU

